



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe të nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës

th ë r r e t

mbledhjen e **shtatë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **23.10.2014**, dhe do të fillojë në orën **15:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Këshillit të Drejtorëve (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozoi këtë

REND DITE:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në Planin rregullues të lagjes "Mati 1", në Prishtinë;
3. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit në fshatin Hajvali;
4. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të propozimplanit për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes "Sofalia" në Prishtinë;
5. Shqyrtimi i raportit financiar tremujor, për periudhën korrik - shtator 2014;
6. Informatë për zgjidhjen e rastit të pronave në lagjen "Dodona";
7. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim Policisë së Kosovës;
8. Propozimvendimi për ndërtimin e lokaleve afariste me partneritet publiko-privat;
9. Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore;
10. Propozimrregullorja për hapjen e kutive të ankesave;
11. Informatë për fillimin e procesit edukativo- arsimor 2014 - 2015;
12. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së Ismail Qemalit;
13. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së Osman Dumoshit;
14. Të ndryshme.

KRYESUESI I KOMITETIT
Halim Halimi, jur. i dipl.

Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues:: 038/234-738 & 038/230-900, lok. 1125.